



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_272_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_392_04_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_392_04_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Hafize Ahmeti (shifra e konsumatorit DPR – 77772) nga Besiana, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 08.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 24.02.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë me kërkesë të konsumatorit për lidhje të re kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 91058752. Te shënimet mbi njehsorin e hequr kanë theksuar se njehsori paraprak nuk eksiton.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 005490 datë 24.02.2009

- Me datë 27.04.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori, ku kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe kanë konstatuar se konsumatori është i lidhur direkt në shtyllë si dhe mungon njehsori elektrik me nr. 10023838.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 826502 të datës 27.04.2009
- Me datë 12.06.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07771 në vlerë prej 299.28 €.
Provë: Fatura DPR09HP07771 e datës 12.06.2009
- Me datë 25.06.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 12.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 12.12.2009
- Me datë 08.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_ 392_04_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar